



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 41-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 17.03. 2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Fitim Shala, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rustemi, anëtare
13. Lulzim Rustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Nazmi Krasniqi, anëtar
16. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
17. Egzona Bytyqi, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Egzona Fazliu, anëtare
29. Fehmi Rexhepi, anëtar
30. Arben Salihu, anëtar
31. Argjend Tasholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Merita Bytyqi, DSH
5. Valon Pacolli, DA
6. Anila Reçica, DKRS
7. Nazim Gashi, DE
8. Hana Berisha, zyrtare e DPU
9. Dhe të tjerë prezent

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj që të kemi një vit të mbarë dhe të keni shëndet dhe suksese ju dhe familjet tuaja,

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit dhe kemi një zëvendësim, të një anëtari të kuvendit nga radhët e LDK-s ku Nehat Tërpezën do ta zëvendësoj Fitim Shala, të cilin e ftoj që ta lexoi deklaratën për betim.

Pastaj kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi tha se anëtarit të ri të kuvendit i urojmë suksese në punë

Në vazhdim tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 29-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2019 dhe 2020 në vitin 2021.
3. Informatë nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale rreth situatës me Pandeminë Covid-19 në Komunën e Lipjanit.
4. Raporti vjetor Janar-Dhjetor 2020 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.
5. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarin e kombit.
6. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre 15NR.011-71878 e datës 27.11.2018.
7. Propozim Vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit.

8. Propozim Rregullore mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.
9. Propozim Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.
10. Propozim Vendim për zëvendësimin e Kryesuesit të Komisionit të Ankesave.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës tha se kam një ndërhyrje te rendi i ditës, kërkoj që pika e 4 e rendit të ditës të jetë në vend të pikes së dytë për shkak të agjendës që e kam të caktuar, po ashtu kërkoj që të jetë edhe një pike shtesë Informatë nga vërshimet e fundit në Komunën e Lipjanit.

Po ashtu I uroj edhe Lëvizjes Vetvendosje fitoren.

Meqë vërejtje tjera as plotësime nuk pati Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi rendin e ditës.

Pastaj u vazhdua me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Ganimete Qeriqi, një fenomen të pranishëm që e shoh çdo ditë, ku punojë qe 20 vite, e besojë e ka vërejtur edhe drejtoresha, ky problem nuk zgjidhet sot, por me rendësi me pas parasysh në të ardhmen, pasi që ndikon në shëndetin tonë të qytetarëve. E kam fjalën për punëtoret e mirëmbajtjes (gratë) në QKMF. të cilat janë duke e vuajtur me kurriz të cilat e bëjnë pastrimin e objektit ku afërsisht ka mbi 5000 metra katror (QKMF 4 kate, emergjenca, stamatoligjija, materniteti). Punëtoret (zakonisht gratë) e mirëmbajnë me mjete ma të pa përshtatshme që ekzistojnë. Është një metodë e egër e punës, sikur tallje me to, metodë diskriminuese, e ultë që një objekt 5000 metra ,të pastrohet me një xhoker dhe kove që si plotëson kushtet të pastrohen as dy metra katror e që kanë drejtë ta kërkojë vetëm një herë në muaj. Shpesh i shoh me djersë në ballë. Kisha propozuar të ju sigurohen fshesa gjeneralë këtyre punëtoreve.

Ramiz Qeriqi, së pari ju uroj fitoren VV-së ju uroj punë të mbarë. Unë kërkoj që në seancën e ardhshme të jetë një informatë rreth arrestimeve të fundit në komunën e Lipjanit, të informohemi në detaje se ku janë shpërnda subvencionet. Le të dënohet ai që e ka krye veprën e jo komuna. Është një kërkesë e qytetarëve të Lipjanit që orari i punës për Çerdhe të jetë deri në ora 17. Një kërkesë e banorëve të fshatit Krojmir, te Pojata për një trotuar pasi që aty dy persona e kanë humbur jetën, për shkak të një trotuari.

Lulzim Rustemi, së pari ju shprehi ngushëllime atyre që kanë humbur familjarët nga pandemia Covid-19, ndërsa të sëmurave ju uroj shërim. Po ashtu edhe Vetëvendosjes i uroj fitoren.

Kam disa çështje për t'i ngritur, e para ka të bëjë me një kërkesë të familjes Gashi nga Janjeva të cilët janë të rrezikuar nga shembja e shtëpisë, kërkoj nga komuna ta formoj një komision të dal në vend të ngjarjes në mënyrë urgjente deri sa nuk ka ndodhë ma e keqja.

Pasi që është një familje për të cilën diskutohet në Komitetin për Komitete që disa muaj. E dyta propozoj që prapë të kthehet në Kuvend kërkesa e PDK-s për të prekurit nga COVID-19. Në mënyrë që të ju ndihmohet të prekurëve nga Covid.

Çështja tjetër ka të bëjë me ndërrimin e drejtorit të shkollës në Ribar të Madh, pasi që aty është Ushtrues i drejtorit të shkollës ish kolegu ynë Nehat Tërpeza, a ka pas shkelje të procedurave ligjore, apo vazhdon të politizohet arsimi ende

Imri Ahmeti, higjiena në QKMF me të drejtë e ngritur, por jemi në proces të blerjes së mjeteve për pastrimin e këtyre objekteve, me mjeteve elektronike dhe mendoj që atje ka një angazhim të madh të punëtorëve që merren me atë punë. Arrestimi i punëtorit të komunës është arrestuar për punën e tij private dhe nuk ka lidhje me punën e komunës. Dhe nuk bartë unë kurrfarë përgjegjësie. Sa i përket rritjes së orarit të punës në çerdhe ne nuk mund ta zgjatim orarin pasi që orari është i rregulluar me ligj dhe me kontratë të punës. Trotuari në Krojmir është i nevojshëm vetëm ajo është në rrugë regjionale edhe vitin e kaluar patëm shikim mundësinë me gjetë zgjidhje për atë çështje por do të shohim prapë ta gjejmë një zgjidhje. Sa i përket familjes Gashi nga Jajeva jam në dijeni por komuna nuk i ka mundësitë me i dhanë banesë dhe mua asnjë ligj në fuqi nuk ma lejon që me marr dikën prej një shtëpie me që me ja dhanë qesat e banesës. Me familjen është bisedua që të zhvendoset diku tjetër por nuk ka pranë. Sa i përket vendimit për ndihmë të prekurve me covid 19, nuk kanë nevojë të gjithë të ju ndihmohet, por ata që kanë nevojë ne do të ju ndihmojmë. Sa i përket arsimit në Lipjan nuk kemi pasur asnjëherë depolitizim me pak se tash, ka dobësi ka të meta. Unë kam zgjedh një ushtrues detyrë të drejtorit deri në procedurat tjera.

Ramiz Qeriqi, unë thash nëse ka mundësi me ndihmu që të zgjatet orari i punës së çerdheve. Unë kërkoj që të jetë një raport detajues për të gjitha subvencionet se ku janë shkuar ato subvencione

Imri Ahmeti, nëse personi zyrtar ka bërë shkelje për çështje zyrtare do të shkonte bashkë edhe me dy anëtar të komisionit, por lidhje me subvencione të komunës kjo punë nuk ka është çështje private e tij.

Lulzim Rrustemi, familja Gashi nga Janjeva janë e rrezikuar nga shembja e shtëpisë dhe po të shembet shtëpia, do të ketë pasoja të pa riparueshme. Ka iniciativë të Kryetarit të Komitetit për komitete për strehimin në një shtëpi tjetër të asaj familje por duhet edhe komuna të ju del në ndihmë. Ndërsa sa i përket zyrtarit të akuzuar ne si PDK kemi dhanë disa herë vërejtjet tona për punën e tij. A keni marrë ndonjë vendim për këtë person.

Imri Ahmeti, personi në fjalë nuk ka lidhje me punët e komunës ka të bëjë me punët e tij private, por unë prapë e kam suspenduar nga puna

Egzona Bytyqi, kërkoj nga drejtorati për shëndetësi rreth vaksinës Kovax, a janë bërë përpjekjet e para që me t'u mbërri kjo vaksinë menjëherë me fillim me dhënien e tyre. Sa ka me qenë numri i dozave që ne si komunë kemi me i siguruar a varet kjo prej neve apo na determinon Ministria e Shëndetësisë. Cilët janë të parët që do të vaksinohen. A do të bëhet vaksinimi vetëm në QKMF, apo edhe në AMF. A është mendu për orarin për stafin mbështetës. Çështja tjetër ka të bëjë me demolimin e trotuarit për të parku i biznesit në Qyldagë a është çështje e komunës apo e ministrisë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, pasi qe 8 marsi është Dita Ndërkombëtare e Gruas e sidomos të grave qe lanë gjurmë në historinë tonë. Ne si Lipjan kemi një dëshmore femër Zylfije Gashi,të cilës nuk i kemi dhanë trajtim të duhur si dëshmore. Ku nuk e kemi nderu asnjë institucion me emrin e saj dhe familja ka kërkesë se të paktën një institucioni të vihet emri i saj. Kërkoj që të ndërmerret ndonjë hap pasi që kjo dëshmore ka rënë 16 prill dhe ndonjë institucion te ketë emrin e saj do të ishte nder për familjen e saj. Do të ishte një propozim i mirë që të ketë çerdhja publike emrin e kësaj dëshmore.

Argjend Tasholli, kam dy pyetje, Stadiumi që e keni planifikuar ta ndërtoni në Gadime kërkesë e imja është qe ky stadium të bartet në periferi të fshatit ndërsa pjesa ku është planifikuar shkolla të jetë një qendër kulturore. Kërkesa ime e dytë është të përfshihet rruga „Ilirida” në Gadime me ndriçim publik.

Nazmi Krasniqi, personi i arrestuar është zyrtar i komunës e i cili është arrestuar në vendin e punës. Sa i përket vërshimeve është dashtë të ketë një raport me herët e jo të vie raporti kaq vonë.

Imri Ahmeti,unë e thash disa herë qe personi i arrestuar nuk ka të bëjë asgjë me punët zyrtare të komunës po është arrestuar për shkak të përfitimin të një subvencioni familjar. Rruga „Ilirida” në Gadime është e parapame në buxhet. E vlerësoj punën e secilit dëshmor.

Albulena Kelmendi,Pandemia na ka shkakto shumë probleme e sidomos në çështjen e arsimit ku edhe kemi pas mungesa të mësimdhënësve shkak i problemeve shëndetësore,Kam për t'i ngritur dy çështje e para ka të bëjë me një kërkesë të banorëve,nxënësve të fshatit Bujan për mungesë të autobusit. Nxënësit nuk po kanë mundësi të vinë në shkollë. Ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me kërkesën e banorëve të Lipjanit, të rrugës Mbreti Zogu e cila rrugë nuk ka ndriçim publik.

Alban Salihu, i gjithë qyteti e ka ditë për këtë zyrtar të arrestuar pasi qe ky person ka vozitë veture 13-14 mijë euro. Ku është anëtar i kuvendit Nehat Tërpeza. Disa drejtor të shkollave i patët edhe delegat në kuvendin zgjedhor të LDK-s.

Argjend Tasholli, unë propozova qe stadiumi të bëhet në periferi të fshatit Gadime. Ndërsa rruga „Ilirida” ne Gadime nuk e pash që është në buxhet.

Imri Ahmeti,ne po vazhdojmë me investime por nuk mundemi në të njëjtën kohë të punojmë në të gjithë vendet. Zyrtari në fjalë nuk akuzohet për punë zyrtare por për punë private të tij. Sa i përket trotuarit te Parku Kërqeva ka qenë përgjegjësi e Ministrisë së Tregtisë dhe Industri dhe ne jemi duke biseduar që ajo punë e kryer të mos pranohet pasi nuk është kryer si duhet. Atje akoma jemi në fazën e hershme për t'u përmbyllë investimet. Sa i përket Arsimit ka një vendim që ja lejon punëtorëve të arsimit me sëmundje kronike dhe grave shtatzëna që të mungojnë në vendet e tyre të punës dhe askush nuk e di se kur ata do të kthehet në punë. Dhe nëse na sot e shpallim një konkurs 45 ditë shkojnë deri sa të fillon punën. Na patëm provu me punëtorë vullnetarë me i zëvendësua punëtorët e arsimit po filluan me na kritiku.

Alban Salihu,unë e thash që qeveria e kaluar ka qenë kriminale dhe zhvatëse,nese ajo i ka pas 20 drejtorë politik ju i keni 10. Pse nuk po reagoni për zyrtarët tjerë që po fliten për korrupsion.

Imri Ahmeti kryetari i komunës,tha ka ligje që i mbrojnë shërbyesit civilë nuk mund të largohet dikush nga puna veç pse flet dikush për ta.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 40-te të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 40-të e Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 40 -të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II.

Raporti vjetor Janar-Dhjetor 2020 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Ahmetit kryetarit të Komunës së Lipjanit, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi,një raport voluminoz në faqe por jo përmbajtësor ,mungojnë sfidat dhe rekomandimet. Një raport i konsumuar.

Lulzim Rrustemi,një buxhet i realizuar mirë por ka edhe shumëçka për të dëshiruar ku kemi një shumë të madhe të mjeteve që kanë shkuar suficit .Te të hyrat vetanake po ashtu edhe të hyrat e bartura kemi shpenzim jo të mirë. Te garantit qeveritar edhe aty nuk është mirë,po ashtu edhe te fushat e sporteve kemi menaxhim jo të mirë dhe realizimi i punëve është shumë i vogël. Te drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim te zona ekonomike në Kërkqevë po bëhen punë jo të mira ka punë që kanë ngecë po ashtu ka menaxhim jo të mirë. Ka projekte që nuk kanë

fillu fare,siç janë projekti i rrugës „Hajredin Bajrami” e disa projekte tjera. Po ashtu gjatë vitin 2020 janë bërë edhe disa shkelje si në arsim, shëndetësi etj.

Bashkim Budakova,kemi të bëjmë me një raport sipërfaqësor dhe jo mirë të detajuar dhe aq ma pak transparent. Te drejtorati i arsimit kemi një paraqitje sipërfaqësore dhe jo drejtë e prezantuar. Në këtë raport nuk e kemi numrin e prekur nga pandemia të mësimdhënësve dhe numrin e orëve të humbura gjatë kësaj kohe dhe nuk kemi pasqyrë se si janë zëvendësuar dhe plotësuar ato orë. Ndërsa sa i përket drejtoratit të Bujqësisë gjatë vitin 2020 janë shpërnda sera dhe motokultivator por edhe për disa familje mekanizma bujqësore. Uroj që këta motokultivatorë të ju hynë në punë fermerëve dhe serat të jenë funksionale.

Imri Ahmeti kryetari i komunës,tha se pari Bashkimit i uroj pozitën e ushtruesit të detyrës së kryetarit të AAK-s në Lipjan. Krahassuar me vitin qe e lamë pas ka avancime ,ka rezultat të shënuar në një vit qe ka qenë tepër sfidues.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në pikën në vazhdim

III

Propozim Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2019 dhe 2020 në vitin 2021.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,e kam cekë edhe në KPF se disa në rrugica në fshatin Shalë kanë mbete të pa asfaltuara dhe nuk e pash qe ka projekt të ri për ato rrugica në Shalë. Kryetari është zotu qe do të përfshihen ato rrugica në fshatin Shalë mirëpo unë nuk i pash qe janë të përfshira ato rrugica.

Ukë Kryeziu,ne edhe në KPF i kemi ngritë shqetësimet tona, dhe kam pritë që do të ketë një reflektim të drejtorit por nuk ka asnjë ndryshim as lëvizje në atë drejtim. Fjala është për projektin e asfaltimit të rrugës Sllavi-Dobratin edhe pse unë e kam ngritë disa herë këtë çështje pasi që është një projekt qe 10 vite e që çdo ditë e sheh të shkatrruar. Unë kërkoj edhe nga kolegët asamblesitë nga ekzekutivi ta ngrisin këtë shqetësim,kolegë ngritne këtë shqetësim.

Qështja tjetër ka të bëjë me hapjen e lumit të Sllavisë pasi qe janë hapur lumenjtë në Gadime ,Smallushë ka mbetë vetëm i Sllavisë qe ta ketë rrjedhën më mirë,pasi që vërshimet e fundit kanë shkaktuar probleme pasi bëhet për interes të përgjithshëm të fshatit.

Hyra Bytyçi, sa i përket propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2019 dhe 2020 në vitin 2021,ky vendim është i bazuar në ligj dhe mirë që po shfrytëzohen në mënyrë efikase për projektet të cilat do të finalizohen dhe projektet e reja të cilat do të realizohen në të mirë të qytetarëve.

Lulzim Rrustemi,te muri në lumin Janjevka ku i bjen saktë dhe çka mendojmë të bëjmë me atë muri. Ndërsa sa i përket projekteve të reja në rrugë regjionale janë të mira për qytetarët, por projektet rreth vërshimeve do të duhej të ju epet më shumë përparësi dhe do të ishte mirë me shku projektet aty ku kryejnë funksion e jo aty ku shihen.

Argjend Tasholli,e kam një pyetje nëse mundeni me ma shpjegu në cilën pjesë gjendet ndriçimi publik në rrugën „Ilirida” në fshatin Gadime pasi që unë nuk po mundem me gjete në këtë propozim.

Afrim Miftari,së pari i uroj punë të mbarë kolegut asambles, e fituesve në zgjedhje ju uroj sukses. Në KPF i patëm disa pyetje dhe disa sqarime i morrëm. Kam një pyetje; te këto projektet e reja që janë, asfaltimi me trotuar te rruga Lugaxhi deri në Gadime dhe te rruga nga Lipjani deri te rrethi i Janjevës a ka pas mundësi këto projekte me kanë të ndamë në dy projekte të reja.

Latif Ramadani, çështja e rrugëve në fshatin Shalë është një projekt nga Ministria dhe do të përfshihen ato rrugë. Rruga nga Sllovia deri në Dobratin këtë herë nuk kena mujtë me parapa por do ta shohim një zgjidhje për atë rrugë. Ndërsa sa i përket lumenjve kemi një kontratë kornizë 3 vjeçare ku do të përfshihet edhe lumi i Sllovisë. Muri mbrojtës në lumin JANJEVKA nuk e di saktë. As për rrugën „Ilirida” në Gadime nuk e di saktë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për aprovoi:

Pastaj Kryesuesi dha pauzë nga ora 12 deri në ora 13:30 minuta.

IV

Informatë nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale rreth situatës me Pandeminë Covid-19 në Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Merita Bytyqit, drejtoreshë e shëndetësisë, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi,një raport i detajuar,ju uroj shërim prej Covid-19 drejtoreshës,shumë i rëndësishëm si raport me statistika edhe pse po përballemi me një pandemi e cila si duket nuk do me u largu. Si duket kemi një rritje në vendin tonë e ku të sëmuarëve ju uroj shërim e atyre që kanë humbur familjarët ju shprehi ngushëllime. Nuk e di sa po funksionon ekipi i patronazhit për personat të cilët janë të prekur me Covid-19,e të cilët janë duke e bërë trajtimin në shtëpi. Kemi respekt për punëtorët e shëndetësisë, por ka prej tyre të cilët edhe kanë abuzu me këtë punë.

Ukë Kryeziu,një raport bukur i kompletuar dhe në detaje,por kam disa vërejte pasi qe sot nëse del në qytet pa maskë policia të gjobitë ndërsa momentin që hyn në kafene aty maska nuk të duhet edhe pse ka grumbull të njerëzve. Nuk menaxhohet pandemia vetëm prej drejtoratit të shëndetësisë por duhet edhe bashkëpunimi me inspektoriatin dhe policinë.Vetëm në QKMF në Lipjan jepen mbi 150 infuzione në dite vetëm për të prekurit me covid 19.çka po

ndodhë me vaksinën astrazeneka a ka fillu me ardhë kur do të vijë kush do ta marr atë vaksinë. Ata të cilët e kanë kaluar virusin a do të vaksinohen. Në vendin ku unë punoj pacientët presin në radhë për t'u kryer një shërbim për shkak të numrit të madh të pacientëve.

Arben Salihu,kam një pyetje në laboratorin ku bëhen analizat në QKMF në Lipjan, në të njëjtin laborator bëhen edhe testet për Covid-19,a është mëndu me u nda një sallë e veçantë për covid ,pasi që në këtë rast rrezikohen edhe qytetarët edhe stafi mjekësor i cili merret me analiza.

Lumturije Bytiq-Hasani,tha se duhet të zgjerohet kujdesi paliativ pasi qe është pak një grup i stafit që shpërndahet nëpër teren. Qeshtja e dytë ka të bëjë me çmimin e barnave dhe terapisë pasi që barnatoret po manipulojnë me çmime të barnave dhe duhet me pas bashkëpunim me drejtoratin e inspektionit. Dhe çështja e tretë ka të bëjë me kujdestarinë e barnatoreve, ku është mirë që të dielave të punojnë dy barnatore për shkak të rritjes së numrit të pacientëve me covid 19, pasi qe kërkesa e qytetarëve është shumë e madhe

Alban Salihu,unë mendoj që barrën kryesore për menaxhimin e pandemisë e ka niveli qendror,komunat ma shumë e kanë pa për detyrë me i respektu udhëzimet që kanë ardhë nga Ministria e shëndetësisë. Mendoj që komuna jonë të reagoj më mirë ku ka pas fluks të qytetarëve e unë nuk kam pa ndonjë reagim serioz në këtë drejtim. Para dy jave kam qenë në QKMF- dhe aty të dy aparaturat dezinfektuese kanë qenë të zbrazura e këtu keni mundësi të reagoni dhe të jeni të kujdesshëm.

Nazmi Krasniqi,një raport i zgjeruar por është dashtë që ky raport të vinte në vitin e kaluar. Të gjithë atyre që kanë humbë të dashurit e tyre ju shprehi ngushëllime,ndërsa të sëmuarve ju uroj shërim. Shpesh herë po ndodh që edhe analizat nuk po dalin të sakta,po ashtu po mungojnë edhe disa barna esenciale. Kam një pyetje a ka ndonjë raport sa personave ju ka rikthye ky virus?

Lulzim Rustemi,jemi vonë me informatë,pa përgjegjësi totale,nuk ka pas debate me qytetar dhe sot është dashtë të fillohet nga vaksina kur kanë me ardhë cilat kategori kanë me i marrë. Duhet mi falënderua të gjitha institucionet për punën që e kanë bërë gjatë kësaj kohe të pandemisë. Ekzekutivi e ka pas partner të fortë Kuvendin për gjithçka. Ka pas edhe ankesa të qytetarëve të cilët kanë qenë të infektuar me covid -19 dhe nuk ju ka ndihmuar askush,vetëm ja ka qu një vendim për izolim inspektorati ose policia. Inspektorati duhet të këtë një kontroll të shtuar.Bile une propozoj që çdo muaj të ketë informatë rreth pandemisë në komunën tonë.

Daut Azemi,debate rreth pandemisë ka pas në kuvend çdo mbledhje,nuk kena pas informatë të shkrume por debat ka pas çdo seancë, a i kena zbatu si duhet masat si qytetarë nuk i kena zbatu. Për vaksina po priten me ardh disa nga Izraeli.

Argjend Tasholli, e falënderoj drejtoreshën për informatën por kam një shqetësim sipas informatave qe i kam kur prindërit po dalin me covid-19, fëmijët nuk po i ndalin nga shkolla por po vazhdojnë t'i ndjekin mësimet në shkollë. A janë të informuar drejtorët e shkollave për këtë dukuri. A ka mundësi mu parandalua kjo dukuri?

Afrim Miftari, e falënderoj drejtoreshën për informatën, ne kemi debatuar gjatë vitin 2020 rreth pandemisë covid-19 dhe duhet me qenë kujdesi i shtuar. Vala e tretë e virusit sa

është reale te ne. A ka raste në Komunën e Lipjanit ku janë disa lloje të Covidit siç janë ai brazilian, grek etj dhe çka dallon Covid 19 prej tyre.

Merita Bytyqi, unë sot e kam ditën e 15 të shërimit ,pas herës së dytë të infektimit me covid-19 dhe jam njëri prej rasteve që për herë të dytë jam infektuar dhe virusi po rikthehet. Në Lipjan janë 3500 vaksina janë bërë përgatitjet por nëse ka interesim të madh ne kemi parapa në salla të sporteve. Ne ju dërgojmë listën inspektoratit të personave të prekur me Covid-dhe ata ju dërgojnë vendimin për izolim të të gjithë familjarëve e sa e respektojnë nuk e di. Ne jemi ende me pandeminë dhe duhet të kemi kujdes. Nëse keni ndonjë informatë që ka ndonjë staf mjeksor që e keqpërdorë detyrën në teren na informoni. Dezinftues kemi në QKMF-pasi që e kemi obligim dhe nuk mendoj që mungojnë. Unë çdo javë raportoj për rastet e testimeve për të prekurit me covid dhe të shëruarit. Sa i përket barnatoreve ajo është detyrë e inspektoratit.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën e radhës.

Shtesë:Vendimi.

V

Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarin e kombit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Hana Berisha zyrtare e DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Arben Salihu,tha se zgjidhja më e mirë do të ishte që të bëhej një pllakë përkujtimore për të gjithë dëshmorët dhe martirët e kombit,pasi që kjo metodë na qysh po zgjidhen po krijon një pa kënaqësi te qytetarët. Me shpenzimet që po bëhen për lapidarët do të ju krijojnë mirëqenie më të mirë për familjarët dhe do të ishte me e qëlluar që të bëhej një pllakë përkujtimore për të gjithë.

Daut Azemi,ka qenë më herët ide e kryetarit që të jetë një pllakë përkujtimore për të gjithë.

Argjent Tasholli,edhe unë mendoj që duhet të jetë një pllakë përkujtimore për të gjithë. Po ashtu mendoj që të Shtëpia e Kulturës në të ardhmen të vendoset edhe shtatorja e Tahir Sinanit pasi që Shtëpia e Kulturës mban emrin e Tahir Sinanit pasi që është një hero kombëtar.

Lulzim Rrustemi,ne me këto propozime vazhdimisht po ngutemi dhe të gjithë kanë të drejtë me u ankuar dhe të gjithë kanë me lyp vend të përshtatshëm. Një zgjidhje jo e mirë,ne si PDK patëm propozuar që të jetë një pllakë e përbashkët për të gjithë te tregu i gjelbërt dhe të gjithë të kenë një vend një përfaqësim,e kjo duhet sa ma shpejtë të bëhet. Zgjidhja ma i mirë do të ishte tash me harta zonale të bëhet.

Daut Azemi, ideja për një pllakë përkujtimore ka qenë e kryetarit,por ju e dini shumë mirë që nuk ka unifikim të listës së dëshmorëve martirëve,nuk mujna na me i shti në konflikt

familjarët,derisa ne nuk e kemi një listë zyrtare nuk mujna me pas një pllakë të tillë. Duhet të ketë unifikim të shoqatave për listën e dëshmorëve,heronjve dhe martirëve. Vullneti i kryetarit është që me pas një pllakë.

Afrim Miftari,ne po flasim për një vendim paraprak për caktimin e lokacioneve,dhe ma e pakta që mund të bëjmë për këta dëshmorë dhe veprimtarin në fjalë është kjo. Është mirë që këto lokacione po përkujtojnë me emrin e rrugëve .Elemente ndërtim dhe krijimin e një shteti janë buka,penda dhe pushka. Pa kombinimin e tyre nuk ka progres një shtet. Është mirë që të hulumtohet se në komunën e Lipjanit a kemi edhe njerëz të pendës. Na në emër të grupit e përkrahim.

Albulena Kelmendi,këta e kanë dhënë kontributin e vet që na sot ta shijojmë këtë liri të cilën po e gëzojmë sot,dhe asnjë shtatore nuk mund ta kompensoj kontributin e tyre. Dy të parët dëshmore Hajredin Bajrami dhe Xhavit Koxhani, te cilët kanë rënë në vijën e frontit respekt për kontributin e tyre. Jam pak konfuze pasi dy shtatoret e para do të ngriten në rrugët ku e mbajnë emrin e tyre,ndërsa e 3ta në rrugën ku e mban emrin e një veprimtari tjetër e i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm e nuk ka shtatore. Ne si grup jemi për këtë lokacion edhe pse i kam dyshimet e mia dhe kundërshtimet sa i përket kësaj pune.

Lulzim Rrustemi, do të ishte mirë që në rrugën Avdi Kelmendi ,në të ardhmen ta nderojmë me shtatoren e profesorit Avdi Kelmendi.

Ramiz Qeriqi,na e dimë që ka pas shumë kërkesa për vendosjen e lapidarëve por ju nuk keni marrë të dhëna nga komandantët të cilët kanë qenë por i keni vendos pa marr të dhëna nga njerëzit përkatës.

Namzi Krasniqi,unë nuk jam kundër asnjërës po është dashtë që të kenë secili hapësirën e caktume ku do të ngritën ato shtatore.

Hana Berisha,detyrë e drejtoratit ka qenë gjetja e hapësirës sipas kërkesës së kryetarit dhe në këto rrugë në të ardhmen mund të planifikohen edhe shtatore tjera dhe ka hapësirë për të gjithë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 6 abstenime aprovoi:

**Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për
varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre
15NR.011-71878 e datës 27.11.2018**

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Anila Reçica, drejtoreshë e DKRS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, kur kemi ardhë në kuvend po thuaj çdo 2 apo 3 muaj kemi nda mjete financiare dhe ka qenë një pakënaqësi, një revoltë për bashkësinë islame për shpenzime të varrimit. Pastaj është punu për një rregullore e cila unanimisht është aprovuar nga ky kuvend dhe kanë qenë të kënaqur që po bëhet një rregullore për shpenzime të varrimit me të cilën qytetarët do të ribursohen nga komuna dhe pas 2 viteve po e kthejnë qysh ka qenë ma herët, le të vazhdon siç është tani. Ne si PDK nuk do ta votojmë.

Daut Azemi, është kërkesë e qytetarëve pasi që po është e vështirë për ta ditën e varrimit me i siguruar mjetet dhe po duhet me i marr diku ,për me lehtësu këtë çështje ekzekutivi ka propozuar qe kjo të ju lehtësohet qytetarëve. Dhe me këtë qytetarët nuk do të paguajnë asnjë cent për shërbimet e varrimit.

Lumturije Bytyq-Hasani, rregullorja ka ardhë si pakënaqësi e qytetarëve, dhe unë mendoj që është hap i ngutshëm pasi që ne nuk kemi një petition të qytetarëve të cilët e kundërshtojnë këtë rregullore.

Daut Azemi, ka pas ankesa edhe atëherë, tash na po e rritim shumën pak dhe e kemi llogaritë që qytetarëve do të ju lehtësohen shërbimet.

Arben Salihu, kjo rregullore po bëhet për të ju lehtësu çështjen qytetarëve. Ndërsa sa i përket pikës tjetër ne mundemi me marr një vendim të veçantë, ku ceket se bashkësitë fetare mund të bëjnë marrëveshje, e në bazë të asaj marrëveshje mos të shkojnë mjetet nga kuvendi por nga kryetari me kusht që të bëhen në bazë të numrit personal të personit që ka ndërruar jetë.

Daut Azemi, vërtetimit do të vinë nga bashkësitë fetare, dhe tash bashkësitë fetare janë të lidhura me shtet dhe automatikisht do të regjistroheshin vdekja.

Albulena Kelmendi, ne të gjithë këtu jemi për interesa të qytetarëve, prej që kam ardhë në këtë kuvend ka ardhë një rregullore prej më të mirave prej që jam unë asambleiste dhe ajo rregullore e ka rregullu këtë çështje ku qytetari është rimbursu. E tash çka po bëhet po dojka bashkësia Islame me i propozuar kryetarit që ai me nda shumën e ku kryetarit ja lejon ligji me i nda vetëm deri në 2 mijë euro. Si subjekt politik jemi kundër kësaj propozimi rregullore. Dhe personalisht mendoj që nuk është e duhura kjo.

Ramiz Qeriqi, mendoj që rregullorja e deritanishme ka qenë ma e mirë, pasi që rregullorja që e kena përpara është në dëm të qytetarëve. Ka pas raste kur qytetarët shërbimet i kanë kryer vet dhe këto pare i ka marr qytetari e tash këto pare ngelin te bashkësitë fetare. Unë mendoj që është mirë që këto mjete të dalin në llogari të qytetarëve. Me qeta paret kanë me u keqpërdorë.

Hyra Bytyqi,sa i përket kësaj propozim rregullore ne si grup parlamentar jemi pro kësaj rregullore,pasi që kjo mënyrë ju lehtëson punët qytetarëve pasi tani ata më nuk kanë nevojë të paguajnë ditën e varrimit.

Lulzim Rrustemi,ne kemi pas një çmin më herët nuk jemi pajtu,kemi kërku ndryshime nuk jemi pajtuar me listat qe na kanë ardhë nga bashkësia Islame.Mendoj qe kjo rregullore duhet të shkojë në këtë mënyrë si është deri në fund të mandatit. Dhe sa i përket kësaj rregullore ne nuk kemi pas asnjë debat të hapur dhe nuk e di asnjë reagim të bashkësisë islame se nuk po funksionon diçka po as të qytetarëve. Dhe nuk e shohim të arsyeshme me ndryshuar këtë rregullore.

Daut Azemi,ne me këtë rregullore po dojna me ja lehtësu punën qytetarëve dhe kjo vlen për të gjitha bashkësitë fetare dhe nuk guxojnë me ju lyp shërbim ekstra qytetarëve, pasi që qytetarët me zero euro do ti kryejnë shërbimet.

Ramiz Qeriqi,çka nëse qytetarët janë ateistë personat të cilët nuk i përkasin asnjë feje si do të ju ndahen mjetet këtyre personave.

Daut Azemi,ka dikush që i kryen vet shërbimet dhe nuk lyp ndihmë prej askujt,kushdo që kërkon ndihmë prej komunës komuna ju ndihmon

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e rregullores dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 14 vota për,7kundër dhe 2 abstenime aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Anila Reçica, drejtoreshë e DKRS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, pyetje ime ishte se cili shërbim po rritet,por e shpjegova po rriten shërbimet e varrimit. Unë me këtë propozim vendim e shoh një shkelje të drejtave të njeriut,pasi që këtu kryetarit i jepim mundësinë vetëm me bashkësitë fetare t'i nënshkruaj marrëveshje por jo edhe me qytetarët.

Daut Azemi edhe më herët e thash,kushdo që kërkon ndihmë prej komunës komuna ju ndihmon

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për 6 kundër dhe 4 abstenime, aprovoi

Shtesë: Vendimi.

VIII

Propozim Rregullore mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Hana Berisha, zyrtare e DPU, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi

Shtesë: Vendimi.

IX.

Propozim Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo- arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Elmaze Behluli,, drejtoreshë e i DKA-së, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturiye Bytyqi, e kam një vërejtje pasi që propozim vendimi ka shumë gabime drejtshkrimore dhe duhet të përmirësohen e jo të na vinë me gabime drejtshkrimore.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi

Shtesë: Vendimi.

X.

Propozim Vendim për zëvendësimin e Kryesuesit të Komisionit të Ankesave.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjithatë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi

Shtesë: Vendimi.

XI.

Informatë nga vërshimet e fundit në Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Nazim Gashi, drejtor i DMSH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, unë dola për diçka tjetër ,ka një informatë,diskutimet tona nuk janë në internet deri sa ka fole drejtoresha për shëndetësi.

Daut Azemi,mundet me ndodhë ndonjë gabim teknik po dalin ato prapë se ato bëhen dhe për ministri jo vetëm për neve.

Nazmi Krasniqi,a ka mjete që personat e dëmtuar nga vërshimet të ndihmohen.

Arben Salihu, a është parapa diçka që nëse në të ardhmen ndodhë ndonjë vërshim prapë, mos me ndodh e njëjta siç ka ndodhur deri tash.

Ukë Kryeziu,në raport në bazë të asaj që munda me lexu deri më tani nuk po e shoh fshatin Sillovi askund as te zonat e prekura nga vërshimet as më pak të prekura as hiç,e kur dihet që në fshatin Sillovi ka pas vërshime,uji i pijes ka qenë i vërshuar,po ashtu edhe fushat e arat janë të mbushura me mbeturina e rrëzë nga vërshimet. Është mirë komisioni me dalë prapë në teren dhe me shiku gjendjen faktike, me shiku dëmi që ju ka bënë ujësjellësit në fshatin Sillovi, ku nuk ka pas 10 ditë ujë të pijshëm,pasi që komisioni se ka bo punën ma të mirë të mundshme.

Alban Salihu,e para nuk është praktikë e mirë me ardhë pikat në ditën e mbledhjes së kuvendit. Se di kush ka qenë pjesë e komisionit vlerësues por kam informata që komisioni ka bërë dallime dhe kanë qenë subjektiv gjatë vlerësimeve të cilat i kanë bërë,ku dy shtëpi afër njëra tjetrës njëri është vlerësuar ndryshe tjetri ndryshe.

Daut Azemi,ekzekutivi ka të drejtë në bazë të rregullores së punës me shtu pika por edhe me i tërheq pikat nga rendi i ditës.

Argjent Tasholli,unë e kam një shqetësim, te xhamia e Elshanve në Gadime,ku në atë vend është ulët dhe aty ka grumbullim të ujit dhe aty duhet të intervenohet. Po ashtu edhe te fshati Qellapek ka problem me vërshime gjatë reshjeve .

Hyra Bytyçi,me sa po e shoh më shumë janë bërë vlerësime rreth ekonomive familjare. Fshati Qylagë nuk është përmend asnjëherë në këtë raport. Ku në Kërqevë janë shkaktuar dëme të mëdha në këtë vend.

Nazim Gashi,dëmet në infrastrukturë përveç dëmeve emergjente vazhdon të bëjë evidentimin e dëmeve në teren,janë duke u evidentuar fytat e ngushtë të cilët shkaktojnë probleme gjatë vërshimeve. Komisionet të cilat janë të caktuara nga kryetari janë profesionale dhe nuk e di që kanë bërë selektime gjatë punës në teren dhe ne kemi dosjet për secilën familje. Nëse nuk është e shënuar fshati Sllovi kërkoj falje se ka ndodhë ndonjë gabim teknik pasi që komisionet kanë dalë në teren në bazë të kërkesave të qytetarëve. Pjesët më të ulëta kanë pas probleme gjatë vërshimeve jo vetëm në Gadime e Kërqevë.

Argjend Tasholli, shkaktari kryesor i këtyre vërshimeve ka qenë faktori njeri ose ndërtimet nga faktori njeri. Ndërsa te xhamia në Gadime kërkoj që të hapet një kanal te ajo pjesë.

Nazim Gashi, shkaktarët e vërshimeve,janë faktorë të shumtë veç pozita e Lipjanit imponon vërshime,ku vine ujërat nga bjeshkët .Qeveria e Kosovës ka nda një fond të veçantë dhe ka dhënë rekomandimet se kush duhet të kompensohet.

Ukë Kryeziu,unë e pash që në këto 3 nivele nuk është përfshi fshati Sllovi, është mirë që të bëhet një analizë e mirë pasi që nuk ka fshat që nuk janë mbyllë kanalet e ujit,janë ndërtuar trotualet askund nuk ka ujëmbledhës dhe ai ujë ka me dalë në sipërfaqe. Janë bërë dëme të mëdha nga vërshimet dhe nuk i keni verifikuar, por vetëm keni shiku a ka pas kërkesa nga qytetarët ose jo.

Lumturije Bytyqi,ti the komisioni nuk ka kry punën ende pse jeni ngut me pru në seancë këtë pikë, kur hale nuk ka përfunduar puna e komisionit në teren.

Argjend Tasholli,mendoj që duhet të bëhet edhe një komision për vlerësimin e terenit,pasi që para një kohe, 10 viteve, nuk ka pas vërshime tash ka vërshime pasi faktori njeri ka ndikuar siç është rasti me autostradën në Qellapek.

Daut Azemi,lumenjtë janë hapë në këtë kohë më shumë se asnjë herë me parë,por uji i grumbulluar nga autostrada ka shkaktuar dëme,por komisioni po e kryen punën e vetë.

Ramiz Qeriqi,ne nuk po të kritikojmë por po të ndihmojmë,në pjesën ku banoj te ABE-a nuk ka dalje të reshurave atmosferike.

Nazim Gashi,ka pas vërshime të mëdha dhe grumbullim të ujit,dhe komisioni është duke vazhduar punën në teren. Reshjat kanë ndodhë në sezonin që nuk kemi pas gjelbërim.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 17,³⁵

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi